

## TEKSTI I THIRRJES

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shkencor e Teknologjik midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë nënshkruar në 2 Maj 2012, Protokollit të Përbashkët mbajtur në 5.12.2014, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me Agjencia Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion (AKKSHI), çel raundin e dytë të thirrjeve për aplikime të përbashkëta kërkimore, tekniko- shkencore, mes Shqipërisë dhe Austrisë.

Kjo thirrje do të jetë e hapur prej datës 10. 04. 2018 deri më 30. 05. 2018.

Kjo thirrje është e hapur në për të gjithë fushat e kërkimit shkencor dhe ndaj të gjithë kërkuesëve shkencor.

Për referencë: “LIGJI Nr. 80/2015 PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Të gjithë të interesuarit, janë të lutur të aplikojnë duke mbushur kërkesat dhe formularët e aplikimit, në dokumentacionin bashkëlidhur kësaj thirrje.

Dokumentat do të dorëzohen në versionin *hard-copy*, pranë Agjencia Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion (**AKKSHI**), brenda afatit të parashikuar në këtë thirrje (10. 04. 2018 deri më 30. 05. 2018).

Për të gjithë kërkuesit, të cilët kanë qenë pjesë e aplikimeve në raundin e parë dhe të shpallur fitues më 8.04.2015, janë të lutur të aplikojnë sërish, por duke propozuar si partnerë në Austri, drejtues të ndryshëm projektesh nga ata të propozuar në raundin e parë. Në këtë kontekst, kjo thirrje nxit vetëm bashkëpunime dhe partneritete të reja.

Projekt- propozimet fituese, do të financohen për një afat kohor prej 2- vitesh, me grante të ndara për secilin vitit, të cilat do të jepen sipas kërkesës dhe në përputhje me tabelen financiare bashkëlidhur në projekt- propozim.

Shuma e grantit për secilin vit, nuk do të jetë më lartë se 500.000 ALL.

Projekt- propozimi, do të përpilohet në shqip dhe në anglisht dhe do të dorëzohet njëkohësisht nga partnerët e projektit në agjencitë dhe shtetet përkatëse.

Në Shqipëri projekt- propozimi, do të dorëzohet në 3- kopje për secilën gjuhë dhe do të jetë i shoqëruar nga *Letra Përcjellëse*, e cila firmoset nga titullari i institucinit kërkimor. (Lutem referohuni ligjit si më lart shënohet)

Projekt- propozimet do të shqyrtohen dhe me tej vlerësohen, sipas sistemeve të miratuara të vlerësimit në secilin shtet, ndërsa fituesi do të shpallet pas krahasimit të vlerësimeve në të dy shtetet.

Projekt- propozimet fituese, do të nisin financimin në vitin 2019.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

No. .... Prot.

**UDHËZIM**

No. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

**PËR**

**PROCEDURËN E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT**  
**TË PROJEKTEVE**  
**QË FINANCOHEN NË KUADRIN E PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIT**  
**SHKENCOR DHE TEKNOLOGJIK**  
**NDËRMJET DY VENDEVE**

**Tiranë,**

**PËRMBAJTJA**

I.	Procedura e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të një Projekti që financohet në kuadrin e Bashkëpunimit S & T ndërmjet dy vendeve .....	Faqe	1
II.	Modeli i Dokumentit të Projektit për Bashkëpunimin S & T ndërmjet dy vendeve .....	Faqe	5
III.	Sqarime për plotësimin e Dokumentit të Projektit për Bashkëpunimin S & T ndërmjet dy vendeve .....	Faqe	6
IV.	Skeda e Expertëve të Vlerësimit për Pranimin e Projektit .....	Faqe	8
	<b>Aneksë</b>	<b>Faqe</b>	<b>9</b>
A.I.	Modeli i Kontratës për Kryerjen e Vlerësimit për Pranimin e Projektit	Faqe	10
A.II.	Modeli i Kontratës së Përgjithshme për Bashkëpunimin S & T ndërmjet dy vendeve	Faqe	11
A.III.	Modeli i Kontratës për Financim Vjetor për Bashkëpunimin S & T ndërmjet dy vendeve .....	Faqe	13
A.IV.	Skema e raportit vjetor për realizimin e detyrave dhe financimit të projektit për vitin në vazhdim dhe projektplanin e punës dhe financimit për vitin pasardhës	Faqe	14
A.V.	Fjalorth i Termave .....	Faqe	18



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

Nr. .... Prot.

**UDHËZIM**

**No. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_**

**PËR**

**PROCEDURËN E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT**  
**TË PROJEKTEVE**  
**QË FINANCOHEN NË KUADRIN E PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT**  
**SHKENCOR DHE TEKNOLOGJIK**  
**NDËRMJET DY VENDEVE**

Në bazë të Ligjit Nr. 7893, datë 22.12.1994, “Për Shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik”, të VKM Nr. 903, datë 26.08.2009, “Për Krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit”, dhe në bazë të VKM Nr. 567, datë 23.10.1995, “Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike”, AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT,

**UDHËZON:**

Personat juridikë shtetërore dhe privatë kanë të drejtë të propozojnë projekte për kërkim e zhvillim, që financohen në kuadrin e Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik ndërmjet dy vendeve.

Projektet e propozuara duhet të mbështesin dhe të synojnë arritjen e objektivave të kërkimeve shkencore e teknologjike të parashtruara në fushat e bashkëpunimit të miratuara nga të dy vendet.

Procedura e paraqitjes dhe pranimit të projekt-propozimeve në kuadrin e Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik ndërmjet dy vendeve kalon përmes këtyre hapave:

1. Thirrja e përbashkët në të dy vendet për paraqitje projekt - propozime.

2. Paraqitja e kërkesës.
3. Kontrolli formal.
4. Vlerësimi i komisioneve të ekspertëve.
5. Marrja e vendimit.
6. Lidhja e kontratës.

### 1. *Thirrja për paraqitje projekt - propozime*

Thirrja e përbashkët për paraqitje projekt - propozime fton anëtarët e komunitetit shkencor në të Dy vendet të paraqesin projekt - propozime të përbashkëta në kuadër të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik ndërmjet Dy vendeve. Thirrja duhet të përmbajë:

- a. Pjesëmarrësit
- b. Aktivitetet
- c. Fushat përparësore
- d. Dërgimin e propozimeve
- e. Adresën e dërgimit
- f. Datën përfundimtare e dërgimit
- g. Aktivitetet që do të financohen
- h. Koston e lejuar

Thirrja duhet të publikohet në të Dy vendet në shtyp dhe nga media elektronike, të paktën Dy muaj përpara datës përfundimtare të dërgimit të projekt - propozimeve.

### 2. *Paraqitja e Kërkesës*

Kërkesa e personave juridikë shtetërorë dhe privatë për financim në kuadrin e Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik ndërmjet Dy vendeve i paraqitet organit që administron Programin e këtij Bashkëpunimi në formën e një projekt-propozimi. Projekt-propozimi duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e Modelit të Dokumentit të Projektit për Bashkëpunimin Shkencor dhe Teknologjik ndërmjet dy vendeve (Pjesa II) dhe duke mbajtur parasysh sqarimet përkatëse në Pjesën III të këtij Udhëzimi. Projekt-propozimi paraqitet në dy kopje, një në gjuhën shqipe dhe në një kopje në gjuhën angleze.

Si rregull, kërkesat për financim projektesh për Bashkëpunimin Shkencor dhe Teknologjik ndërmjet dy vendeve bëhen brenda datës përfundimtare për pranimin e tyre që jepet në "Thirrjen" e shpallur nga Drejtoria e Kërkimit Shkencor.

### 3. *Kontrolli Formal*

Në AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT kontrolli formal bëhet nga Drejtoria e Programeve Ndërkombëtare. Ajo *synon* të vlerësojë nëse projekt-propozimi është formuluar në përputhje me Modelin e Dokumentit për Projekt në kuadrin e Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik ndërmjet dy vendeve, si dhe nëse në të janë specifikuar qartë fushat përkatëse të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve. Në rast se nuk i përmbush kërkesat e lartpërmendura, projekt-propozimi kthehet për t'u plotësuar.

Plotësimet dhe korrigjimet e nevojshme bëhen brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së projekt-propozimit, por duke mos kaluar datën përfundimtare të pranimi të tyre.

#### 4. *Vlerësimi i Komisioneve të Ekspertëve*

Projekt-propozimi që kalon kontrollin formal i jepet për ekspertizë komisionit të ekspertëve, që bën *vlerësimin përmbajtësor* të tij.

Drejtoria e Programeve Ndërkombëtare thërret Komisionet e Ekspertëve për kryerjen e misionit të vlerësimit për pranimin e projekt-propozimit të cilët janë miratuar më parë nga Bordi Drejtues i AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT.

Pjestarët e tij zgjidhen specialistë të fushave përkatëse që nuk janë pjestarë të personelit të projektit ose të organeve vendim-marrëse të institucioneve që e kanë propozuar atë, ose që, si rregull, nuk kanë marrë pjesë në ekspertizat e bëra nga këto institucione në kuadrin e procedurave të tyre të miratimit të projekt-propozimit.

Pasi bën vlerësimin e projekt-propozimit, komisioni i ekspertëve paraqet raportin e vlerësimit për pranimin e tij, sipas skedës të ekspertëve të vlerësimit për pranimin e projektit të bashkëlidhur në Pjesën IV të këtij Udhëzimi.

Komisioni i Ekspertëve shpërblehet për punën e kryer me vlerën e plotë të ditëve të punës të pagës për titullin “Prof.” të specifikuara në kontratën e lidhur në mes palëve, që formulohet sipas modelit në Aneks I.

#### 5. *Marrja e Vendimit*

Marrja e vendimit për zgjedhjen e projekt-propozimeve bëhet nga një Komision Miks i përbërë nga përfaqësues të të dy vendeve. Komisioni Miks mblidhet në mënyrë të alternuar sipas radhës në vendet e bashkëpunimit. Komisioni ka për detyrë të përcaktojë, pas shqyrtimit të vlerësimeve të ekspertëve listën e projekteve që do të financohen nga të dy palët. Pas këtij përcaktimi zhvillohet Mbledhja e Përbashkët e delegacioneve të të dy vendeve për projektet që do të pranohen për t'u financuar dhe nënshkrimi i Protokollit. Delegacionet udhëhiqen nga titullarët e institucioneve që administrojnë Programin e Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik në të dy vendet. Delegacionet marrin vendimin përfundimtar dhe nënshkruajnë Protokollin e Përbashkët të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik.

## *6. Lidhja e Kontratës*

Nëse projekt-propozimi miratohet për financim, lidhet kontrata, sipas modelit të Kontratës së Përgjithshme bashkëlidhur në Aneks II, ndërmjet përfaqësuesit të institucionit që administron Programin e Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik të të dy vendeve dhe institucionit shkencor që ka paraqitur kërkesën, të përfaqësuar nga titullari dhe drejtuesi i projektit. Kontrata për financim vjetor, paraqitur sipas modelit që jepet në Aneks III, lidhet ndërmjet përfaqësuesit të institucionit që administron Programin e Bashkëpunimit S & T dhe Drejtuesit të Institucionit Shkencor.

**GERON KAMBERI**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

## **II. Modeli i Dokumentit të Projektit**

**Për**

**Bashkëpunimin Shkencor dhe Teknologjik ndërmjet dy venedeve**



### **III. Sqarime për plotësimin e Dokumentit të Projektit për Bashkëpunimin Shkencor dhe Teknologjik ndërmjet dy vendeve**

Plotësimi i saktë i Dokumentit të Projektit për Bashkëpunimin Shkencor dhe Teknologjik ndërmjet dy vendeve sipas kërkesave të Modelit të dhënë më sipër ka rëndësi të veçantë, sepse mbi këtë dokument bazohet zgjedhja ose refuzimi i projekt-propozimit për financim. Në plotësimin e tij të duhet të mbahet parasysh sa vijon:

- Në paragrafin A1 të Dokumentit shënohet me kryq kuadrati për tipin e projektit.
- Në paragrafin A2 të Dokumentit shënohet me kryq kuadrati për fushën në të cilën paraqitet projekti, sipas numrit përkatës të fushave përparësore, që jepen në "Thirrjen" për projekt - propozime.
- Në paragrafin A3 të Dokumentit shënohet Titulli i Projektit.
- Në paragrafin A4 të Dokumentit shënohen Akronimet nese ka.
- Në paragrafin A5 të Dokumentit shkruhet me numër kohëzgjatja e përfundimit të projektit.
- Në paragrafin A6 të Dokumentit shënohet Data kur është programuar të fillojë projekti.
- Në paragrafin A7 dhe A8 të Dokumentit shënohen informacionet për drejtuesit e projektit të të dy vendeve.
- Në paragrafin A9 të Dokumentit shënohen kontributet financiare për koston totale të projektit dhe atë të kërkuar nga secili vend.
- Në paragrafin B1 të Dokumentit shënohen informacione për partnerët e grupit të punës dhe institucionalë të vendit tjetër. Duhet të shënohet me kryq tipi i Institucionit.
- Në paragrafin B2 të Dokumentit shënohen informacione për partnerët e grupit të punës dhe institucionalë të vendit tonë. Duhet të shënohet me kryq tipi i Institucionit.
- Në paragrafin B3 të Dokumentit shënohen kontributet financiare për koston totale të projektit dhe atë të kërkuar nga secili institucion për të dy vendet.
- Në paragrafin C të Dokumentit duhet të jepet përshkrimi i projekt - propozimit. Ky paragraf ka disa nënparagrafë të renditur si më poshtë dhe ku kërkohet të përshkruhet qartë dhe saktë:
  - C1 - Përmbledhja e projekt - propozimit

- C2 - Qëllimet dhe objektivat e projekt - propozimit
  - C3 - Rezultatet e pritshme dhe përfitimet e projekt - propozimit
  - C4 - Gjendja e studimeve në fushën e projektit dhe në nivelin ndërkombëtar
  - C5 - Përvoja e ekipeve të dy vendeve në fushën e projektit
  - C6 - Metodologjia e propozuar dhe justifikimi i saj
- 
- Në paragrafin D duhet të shënohen aktivitetet kryesore, një plan pune për secilin ekip kërkimor për të dy vendet dhe të planifikohen qartë vizitat shkencore përkatëse në të dy vendet.
  - Në paragrafin E duhet të jepet kostoja e projekt - propozimit për të dy vendet duke plotësuar rigorozisht tabelat përmbledhëse për secilin vend përkatësisht.
- 
- Në tabelën e shpenzimeve për palën shqiptare duhet të mbahet parasysh që zërat e veçantë të tabelës duhet të plotësohen sipas artikujve të klasifikimit buxhetor si më poshtë:
    - Në artikullin “*Shpenzime Udhëtimi*” përfshihen shpenzimet për dieta, transport dhe fjetje sipas dispozitave në fuqi për dietat.
    - Në artikullin “*Materiale e Furnitura*” përfshihen të gjitha shpenzimet për blerje materialesh kryesore e ndihmëse, duke përfshirë edhe shpenzimet për inventarin e imët dhe shtypshkrime.
    - Në artikullin “*Shërbime bazë*” përfshihen shpenzimet për energji elektrike, ujë telefon, postë, riparim pajisjesh e aparaturash, si dhe shpenzimet për marrje ose përgatitje kampionesh, kryerje analizash ose provash, ruajtje materiali gjenetik e shpenzime të tjera të kësaj natyre.
    - Në artikullin “*Shpenzime transporti*” përfshihen shpenzimet për karburant, goma, pjesë ndërrimi, riparime, etj..
    - Në artikullin “*Shpenzime të tjera operative*” përfshihen pagesa të ndryshme për qera, simpoziume, instalime, konfigurime, punime softi, botime, etj..
    - Në artikullin “*Shpenzime kapitale*”, tek “*Pajisje Profesionale*” përfshihen shpenzimet për blerje aparaturash, pajisje e makineri profesionale, etj., që nevojiten për realizimin e projektit në vitin e parë. Këtu bëjnë pjesë pajisjet kompjuterike dhe softet që nevojiten për realizimin e projektit. Kjo vlerë nuk duhet të kalojë shumën prej 2.000.000 Lekë.
- 
- Paragrafi F do të plotësohet nëse në projekt-propozim përfshihen sipërmarrje private.

## **V. Skeda e Ekspertëve të Vlerësimit për Pranimin e Projektit**

## **ANEKSE**

## K O N T R A T Ë

### Për kryerjen e Vlerësimit për Pranim Projekti

E lidhur sot më ..... ndërmjet:

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT  
përfaqësuar nga Z.....Drejtor i Përgjithshëm dhe grupit të  
ekspertëve të përbërë nga:

1. ...., Kryetar;
2. ...., Anëtar;
3. ...., Anëtar.

për kryerjen e vlerësimit për pranim të projektit me titull:

.....  
.....  
.....  
.....  
.....

që kërkohet të financohet në kuadrin e Programit të Bashkëpunimit Shkencor &  
Teknologjik ndërmjet dy vendeve.

Vlerësimi do të bëhet për ..... ditë të plota pune të pagës së profesorit  
për secilin ekspert.

**Përfaqësuesi i Organit Financues**  
(Titulli dhe/ose Grada, Emri, Mbiemri, Firma)

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

**K O N T R A T Ë**

**E PËRGJITHSHME PËR PROJEKT KËRKIMI DHE ZHVILLIMI\*  
NË KUADËR TË BASHKËPUNIT SHKENCOR DHE TEKNOLOGJIK  
NDËRMJET DY VENDEVE**

Sot, më datë ....., në Tiranë, ndërmjet:

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT  
përfaqësuar nga Z .....Drejtor i Përgjithshëm, si përfaqësues i organit  
financues,

dhe

Z. .... Drejtor i Agjencisë Ekzekutive, dhe

Z. .... drejtues i grupit kërkimor, lidhet kontrata  
me kushtet që vijojnë:

1. Dokumenti i Projektit për Kërkim dhe Zhvillim me titull:

.....  
.....  
.....  
.....

i paraqitur për financim në kuadrin e Programit të Bashkëpunimit Shkencor dhe  
Teknologjik ndërmjet dy vendeve bëhet pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

2. Financimi i projektit fillon më datë .....

Projekti do të financohet me ..... Lekë.

Për projekte që zgjasin më shumë se një vit, fondi për vitin pasardhës jepet pasi  
paraqitet raporti për realizimin e detyrave të vitit paraardhës dhe pasi është  
lidhur kontrata për financim vjetor sipas modelit të dhënë në Aneks III.

3. Aparaturat, pajisjet dhe baza tjetër materiale e nevojshme për kryerjen e studimit,  
sigurohet nga pala zbatuese, sipas rregullave financiare në fuqi (për prokurim,  
etj.).
4. Agjencia ekzekutive, sipas nevojave dhe specifikave që ka projekti harton  
metodika, plane pune mujore, etj, për realizimin e tij.
5. Në rast se gjatë kryerjes së projektit lind nevoja për të bërë ndryshime në  
objektivat e tij, në afatet e kryerjes se fazave të ndryshme apo të projektit në tërësi,  
në personelin kryesor (punonjësit shkencorë), ose për lëvizjen e fondeve nga  
destinacioni i caktuar, ato mund të bëhen vetëm me dijenin dhe miratimin e  
organit që financon projektin (OQFP). Për këtë paraqitet kërkesë me shkrim.
6. Pala zbatuese, në fund të çdo viti, për projektet që zgjasin më shumë se një vit, i  
raporton me shkrim organit që financon projektin për rezultatet vjetore të  
projektit dhe i dërgon në të njëjtën kohë planin e detajuar të punës për vitin

---

\* Palët, sipas specifikave të rastit, mund të heqin ose modifikojnë pikat e parashikuara në këtë model ose të  
shtojnë të tjera kur e shohin të nevojshme.

pasardhës, sipas modelit të dhënë në Aneks III. Në raste të veçanta, kur ecuria e projektit, për arsye të ndryshme nuk është normale, raporton edhe më përpara se ky afat.

7. Organi që financon projektin, kur e sheh të nevojshme, bën vlerësime afatmesme, kontrole dhe përcakton masa për ecurinë e mëtejshme të projektit.
8. Një kopje e studimit dhe e oponentëve, vihet në dispozicion të organit që financon projektin, i cili organizon vlerësimin përfundimtar me grup ekspertësh, jo më vonë se dy muaj nga data e paraqitjes së materialit përfundimtar. Së bashku me studimin dorëzohet dhe situacioni përfundimtar i shpenzimeve të kryera sipas zërave.
9. Përdorimi i rezultateve dhe i informacionit të studimit nga zbatuesit do të jetë:
  - a. i lirë;
  - b. me autorizim të organit që financon projektin (në rastet kur informacioni dhe rezultatet përbëjnë vlera shtetërore dhe komerciale të veçanta).
10. Kur afati i kryerjes së studimit nuk respektohet për arsye të mosfinancimit në kohë, mban përgjegjësi organi që financon projektin, ndërsa për arsye të tjera mban përgjegjësi institucioni zbatues.
11. Në rastet kur puna e kryer nuk u përgjigjet kërkesave të kësaj kontrate, dëmin financiar të shkaktuar e shlyen institucioni që kryen studimin.

Kontrata është e vlefshme deri në fund të afatit të projektit, me përjashtim të rasteve kur, nga të dy palet, ajo shpallet e pavlefshme.

Kontrata u përpilua në dy kopje me vlerë të barabartë. Secila palë mban një kopje.

**Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese**

**Përfaqësuesi i Organit Financues**

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor**

**KONTRATË**  
**PER FINANCIM VJETOR**  
Viti .....

Sot, më datë ....., në Tiranë, ndërmjet AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT, përfaqësuar nga Z.....Drejtor i Përgjithshëm, Organ Financues, dhe ....., Agjenci Ekzekutuese, përfaqësuar nga Z. ...., drejtues i projektit me titull:

.....  
.....

në vijim të Kontratës së Përgjithshme ndërmjet palëve, lidhur më datë për financimin e projektit në kuadrin e Programit të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik ndërmjet dy vendeve, lidhet kontrata me kushtet që vijojnë:

1. Për vitin .....projekti do të financohet me .....Lekë.
2. Financimi do të bëhet konform specifikimeve të pasqyrës së planit të financimit që i bashkangjitet kësaj kontrate.
3. Në fund të vitit drejtuesi i projektit duhet të paraqesë raportin vjetor për ecurinë e projektit.
4. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit ruan të drejtën e tërheqjes së fondeve të mbetura pa përdorur ose të autorizimit për përdorimin e tyre nga Agjencia Ekzekutuese për destinacion tjetër.

**Përfaqësuesi i Agjencisë Ekzekutuese**



**SKEMA E RAPORTIT VJETOR**

**Për realizimin e detyrave dhe financimit për vitin në vazhdim  
dhe  
Projektplanin e punës dhe financimit për vitin pasardhës**

Çdo drejtues projekti është i detyruar të bëjë raportin e ecurisë së projektit në fund të çdo viti deri në përfundimin e projektit, qoftë ky një, dy apo tre vjeçar.

Raporti vjetor bëhet për çdo projekt në veçanti dhe i paraqitet organit financues në dyjavorin e parë të muajit Janar të vitit në vazhdim. Raporti në përmbajtje duhet t'i përmbahet skemës së mëposhtme:

- I. Raporti për realizimin e detyrave të parashikuara në planin e punës dhe financimit (Aneks IV/1).
- II. Pasqyra e realizimit të financimit sipas artikujve (Aneks IV/2).
- III. Projektplani i detajuar i punës për vitin pasardhës (Aneks IV/3).
- IV. Projektplani i financimit të projektit për vitin pasardhës (Aneks IV/4).

**AGJENCIA EKZEKUTUESE**

**RAPORT**

**Për realizimin e detyrave dhe financimit për vitin .....**

**dhe**

**Projektplani i punës dhe financimit për vitin .....**

**i**

**Projektit:**

**Afati:**

**Numri (Kodi) i Projektit:**

## **I. Raport për realizimin e detyrave dhe financimit për vitin .....(në vazhdim)**

- Nga detyrat (aktivitetet) që përmban plani i punës për vitin ..... janë realizuar:

(jepen një për një realizimi i detyrave dhe rezultatet e arritura, të shprehura në tregues sasiorë dhe cilësorë, si dhe lidhja e tyre me objektivat dhe rezultatet e pritshme sipas dokumentit të projektit).

- Nga detyrat e parashikuara nuk janë realizuar:

(jepen një për një detyrat që nuk janë realizuar dhe shkaqet e mosrealizimit).

- Detyra të tjera që janë realizuar në kuadrin e projektit, që nuk ishin parashikuar në planin vjetor.
- Një tablo e shpenzimeve financiare dhe problemeve që mund të kenë dalë.
- Jepet numri i punonjësve shkencorë dhe i atyre ndihmës të angazhuar në projekt gjatë vitit.

**Plani i detajuar i punës për vitin ..... (pasardhës)**

Emertimi Agjencisë Ekzekutuese:

.....

Titulli i projektit: .....

Afati: .....

**Plani i detajuar i punës për vitin .....**

Nr.	Objektivi dhe Rezultati i pritshëm	Veprimtaritë që do të kryhen	Afati	Personi përgjegjës
1	<b>Objektivi:.....</b> <i>Rezultati: .....</i>  <i>Rezultati: .....</i>	1. 2. 3. etj.  1. 2. 3. etj.		
2.	<b>Objektivi:.....</b> <i>Rezultati: .....</i>  <i>Rezultati: .....</i>	1. 2. 3. etj.  1. 2. 3. etj.		

**Drejtuesi i Grupit Kërkimor****Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese**

## Fjalorth i Termave

1. **Aktualiteti**, është shkalla në të cilën arsyet, objektivat dhe ndikimi i pritshëm i një projekti është ose mbetet i vlefshëm dhe i rëndësishëm në lidhje me objektivat afatgjata ose nevojat dhe shqetësimet prioritare të kohës.
2. **Efektiviteti**, është matësi i masës në të cilën një projekt arrin objektivat e tij.
3. **Inputet**, janë mallrat, shërbimet, personeli dhe burimet financiare që jepen për një projekt, nga të cilat pritet nxjerrja e rezultateve dhe arritja e objektivave të tij.
4. **Monitorimi**, është mbikëqyrja e vazhdueshme e zbatimit të një projekti. Ai synon të japë siguri se inputet, rezultatet e synuara dhe aktivitete e tjera të nevojshme vazhdojnë në përputhje me planin.
5. **Ndikimi**, është shprehja e ndryshimeve të sjella në një situatë si rezultat i zbatimit të projektit. Ai mund të vlerësohet më mirë në afate të gjata (nëpërmjet vlerësimit Ex-Post), se sa gjatë ose menjëherë pas mbarimit të projektit.
6. **Objektivat**, janë qëllimet e projektit; janë ato që përfaqësojnë gjendjen e dëshiruar që pritet të arrijë ai.
7. **Përfituesit nga projekti**, grup njerëzish dhe/ose institucionesh që përfitojnë nga projekti. Ata ndahen në:
  - *Përfituesit direkt*, që përfitojnë drejtpërdrejt nga inputet dhe aktivitetet e projektit.
  - *Përfituesit indirekt*, që përfitojnë nga zgjidhja e problemit që trajton projekti, ndonëse nuk marrin pjesë të drejtpërdrejtë në realizimin e tij.
8. **Projekt**, është një aktivitet i planifikuar që ka për qëllim arritjen e disa objektivave nëpërmjet mjeteve të specifikuara, brenda një periudhe të caktuar kohe dhe mbështetje financiare.

9. **Rezultatet** (Outputet), janë produktet specifike që projekti pritet të nxjerrë ose të japë nga inputet, me qëllim që të arrihen objektivat e tij.
10. **Thirrje**, është një dokument që fton anëtarët e komunitetit shkencor të të dy vendeve për të aplikuar me projekt propozime në fushat që citon.
11. **Vlerësimi**, është një proces që synon të përcaktojë në mënyrë sa më objektive rëndësinë, efektivitetin dhe ndikimin e një projekti nën dritën e objektivave të tij. Ai është një instrument drejtimi dhe një proces organizativ i nxjerrjes së mësimave dhe i orientimit drejt veprimit për përmirësimin e aktiviteteve që janë planifikuar të kryhen si dhe programimin dhe marrjen e vendimeve për të ardhmen.

## SKEDË E VLERËSIMIT TË PROJEKTIT

*Titulli i Projektpropozimit: .....*

Nr	KOMPONENTET QË VLERËSOHEN	Pikët e Projektit	
		Maksim. i mundshëm	Vlerësimi
<b>1.</b>	<b>Rëndësia dhe vlera shkencore</b>	<b>32</b>	
a.	Vlera shkencore	6	
b.	Vlera aplikative	6	
c.	Mundësia e zbatimit të tij.	6	
d.	Transferimi i know-how	4	
e.	Trajnimi i kërkuesve të rinj	6	
f.	Produkte, procedura, shërbime të reja	4	
	<i>Koment (n.q.s. ka)</i>		
<b>2.</b>	<b>Niveli shkencor i projektit</b>	<b>15</b>	
	<i>Koment (n.q.s. ka)</i>		
<b>3.</b>	<b>Vlerat e projektit ne raport me</b>	<b>14</b>	
a.	Karakterin inovativ	4	
b.	Origjinalitetin	5	
c.	Arritjet në fushën e projektit me të dy vendet	5	
	<i>Koment (n.q.s. ka)</i>		
<b>4.</b>	<b>Metodologjia e përdorur</b>	<b>10</b>	
	<i>Koment (n.q.s. ka)</i>		
<b>5.</b>	<b>Planifikimi dhe realizueshmëria</b>	<b>4</b>	
a.	Planifikimi i aktiviteteve dhe intensiteti i tyre	2	
b.	Realizueshmëria e objektivave	2	
	<i>Koment (n.q.s.ka)</i>		

<b>6.</b>	<b>Planifikimi i buxhetit të projektit (për Palën Shqiptare)</b>	<b>9</b>	
a.	Përputhja e buxhetit me aktivitetet e planifikuara	3	
b.	Financimi nga vetë institucionet pjesëmarrëse	3	
c.	Pjesëmarrja e institucioneve të tjera ose ndërmarrjeve prodhuese (n.q.s. ka)	3	
	<i>Koment (n.q.s. ka)</i>		
<b>7.</b>	<b>Eksperiencia dhe specializimi i stafeve kërkimore në fushën e projektit</b>	<b>10</b>	
	<i>Koment (n.q.s. ka)</i>		
<b>8.</b>	<b>Vlerësim për cilësinë e plotësimit të dokumentacionit të projektit</b>	<b>6</b>	
a.	Plotësimi i rubrikave, tabelave dhe shtojcës së formularit të aplikimit	2	
b.	Plotësimi i CV-ve	2	
c.	Paraqitja estetike e materialit	2	
	<i>Koment (n.q.s. ka)</i>		
<b>GJITHSEJ:</b>		<b>100</b>	

### KOMENTE

---



---



---



---



---



---



---



---



---



---

<b>Eksperti Vlerësues</b> <i>(pikat 1-8):</i>	Firma	Data



**AUSTRIA/ALBANIA**  
**SCIENTIFIC & TECHNOLOGICAL COOPERATION**  
**(WTZ Programme)**  
**CALL FOR APPLICATIONS FOR JOINT PROJECTS in 2019-2020**

**CLOSING DATE: June 30, 2018**

The programme for Scientific & Technological Cooperation is carried out in the frame of the bilateral "Agreement between the Government of the Republic of Austria and the Council of Ministers of the Republic of Albania" on the Scientific and Technological Co-operation of May 2, 2012 and is financed equally by the Austrian Federal Ministry of Education, Science and Research (BMBWF) and by the National Agency for Scientific Research and Innovation.

**Aims of the Programme**

- Funding researchers' mobility in the frame of joint research projects to stimulate international research cooperation
- Providing an opportunity for researchers to cooperate in an international setting and to develop their scientific careers, especially for early-stage<sup>1</sup>, mid-career<sup>2</sup> as well as female researchers

**Areas of Cooperation**

The Call is open to all scientific disciplines and thematic areas, including social sciences as well as humanities.

**Duration of projects**

The projects will be supported for a period of max. two years from **January 2019 until December 2020**.

**Who may apply?**

---

<sup>1</sup>Researchers with an experience up to 5 years after their PhD/Doctoral degree; recognized career breaks will be taken into account (e.g. due to family reasons, health reasons or occupation outside the academic sector).

<sup>2</sup>Researchers with an experience of 5 to 15 years after their PhD/Doctoral degree; recognized career breaks will be taken into account (e.g. due to family reasons, health reasons or occupation outside the academic sector).

**AUSTRIA:** Researchers working at Universities, Universities of Applied Sciences and other legal entities (e.g. higher education and research institutions, companies) planning to carry out a non-profit-oriented research project within the frame of this call are eligible for application.

Project proposals submitted by early-stage<sup>1</sup> or mid-career researchers<sup>2</sup> as well as project proposals with involvement of PhD/doctoral students, early-stage<sup>1</sup> and/or female researchers will be particularly considered.

The focus of the programme lies on new international partnerships. Follow-up proposals with the same research partners will not be eligible for funding if they have already been funded under this programme.

**ALBANIA:** The researchers from Albania participating in this Programme, should be Researchers that are part of a research institution; early-stage or mid-career researchers as well as project proposals with involvement of PhD/doctoral students, early stage and/or female researchers. All of the researchers should find ground of support based on the Law for Higher Education and Scientific Research in the Albanian Republic, No. 80/2015, specifically Article 24; 26; 93; 95.

Criteria which have to be fulfilled for application in this Programme are new international partnerships. Follow-up proposals with the same research partners will not be eligible for funding if they have already been funded under this programme.

### **How do I apply?**

It is up to the applicants to find their own research partners. Proposals must be submitted both in Austria (OeAD GmbH) and in Albania (National Agency for Scientific Research and Innovation-NASRI). Proposals which have not been submitted in both countries will not be considered for funding. The Call process is highly competitive therefore application does not guarantee funding.

**AUSTRIA:** The entire application for the research project must be submitted in English online under [\[Link\]](#). The application has to include the following documents (in PDF format):

- Brief academic CV for each Austrian project member
- List of relevant publications of the last 2 years on the Austrian side
- Project description including the methodological part (3 to 5 A4 pages)
- Brief description of the partner institution
- Short description of the project tasks of ALL project members (Austrian and Albanian)
- Further cooperation perspective

**ALBANIA:** The entire application for the research project must be submitted in Albanian and in English and will have to be submitted in hardcopy in the premises of The National Agency for Scientific Research and Innovation. Address: Str. Papa Gjon Pali i II, No. 3, Tiranë 10101, ALBANIA.

### **Which activities may I apply for?**

The purpose of this call is to support the mobility of researchers between the participating countries to carry out joint research projects. In this regard, funding will be made available for visits and exchanges of scientists conducting joint research.

**The sending state will pay the travel expenses whereas the accommodation expenses will be financed by the hosting state (and vice versa).**

**In Austria in well-justified cases and only within the granted maximum budget EUR 400.- per project may be applied for consumables (lump sum).**

### **Funding modalities**

Funding will be available for a maximum of two years for collaborative research projects jointly developed and completed by researchers on both sides.

### **Funding limits**

#### **AUSTRIA:**

The total sum of **EUR 8,000.-** per project (**EUR 4,000.-** per project per year) can be applied for. The funds can be calculated as follows:

- Travel expenses: **EUR 400.-** per trip for Austrian researchers travelling to Albania (lump sum)\*  
\*In case the travel expenses are 50 % of the lump sum or less, only the actual expenses will be refunded upon submission of the travel receipts.
- Accommodation expenses: **EUR 100.- per day** for Albanian researchers travelling to Austria **for up to 14 days OR EUR 1,500.- per month** for long-term visits **between 15 days and 3 months** maximum.
- Consumables: **EUR 400.-** lump sum per project in justified cases as part of the granted maximum budget.

#### **ALBANIA:**

The total sum of **EUR 8,000.-** per project (**EUR 4,000.-** per project per year) can be applied for. The funds can be calculated as follows:

- Travel expenses: Per each trip of Albanian researchers travelling to Austria the travel tickets will be acquired case by case, respecting the national rules and regulations of public procurement.
- Accommodation expenses:  
**For** Austrian researchers/scientists/students/graduates/experts travelling to Albania NASRI will pay a daily allowance of **ALL 8,600.-** (including accommodation) for maximum 10 (ten) days.  
Up to the 20<sup>th</sup> day max 10 day allowances (= **ALL 86,000.-**). From the 21<sup>st</sup> day one full month allowance (= **ALL 110,000.-**).

#### ***Please note:***

- Should you be successful you will be funded only for the activities within the scope of the guidelines
- Scientific and financial reporting on the project is **OBLIGATORY**

- Research stays in both countries are **OBLIGATORY**

### **How are applications evaluated?**

Following the closing date of the call indicated below, applications will be submitted to recognized national experts in the various fields of research represented by the proposals received. These experts will evaluate each proposal based on the national criteria:

#### **AUSTRIA:**

- Scientific quality of the intended research project includes:
  - Feasibility of the joint research plan
  - Adequacy of the scientific method
  - Competence and expertise of the scientists/research teams involved (max. 25 points)
- Plausibility of the described further cooperation perspective (max. 15 points)
- Project proposals submitted by early-stage or mid-career researchers (10 points) OR project proposals with the involvement of doctoral students, early-stage (5 points) or female researchers (5 points) will receive up to 10 points additionally. (max 10 points)

#### **ALBANIA:**

- The importance and scientific value. (max. 32 points)
- The stand of the scientific proposition of the project (max. 15)
- The value of the project in terms of originality; innovation and application on both countries (max. 14)
- Methodology (max. 10)
- Planning and feasibility (max. 4)
- Budgeting (max. 9)
- Experience and staff specialization in the research field of interest (max. 10)
- The evaluation of the documents requested for application (max. 6)

Following national evaluation, a joint shortlist of projects to be funded will be constituted through consultations between the OeAD GmbH and the National Agency for Scientific Research and Innovation based on the results of the national evaluations. The project selection will be carried out by the Austrian-Albanian Joint Commission on Scientific and Technological Cooperation. The results of the project selection meeting will be announced presumably by **December 2018**.

### **Projects follow-up and reporting**

- A final scientific and financial report has to be submitted in English by both the Austrian and the Albanian project leaders no more than 3 months after the end of the project.
- The report has to mention outputs of the projects compared with the objectives and aims of the proposal.
- The final report must include a short, concise summary comprehensible to lay persons. The final report will be available for researchers within this programme working in similar disciplines.
- Joint publications by researchers have to mention the support from BMBWF and the National Agency for Scientific Research and Innovation.

### **Intellectual property**

The researchers of each country must take adequate steps to ensure protection and sharing of the intellectual property that could result from the joint projects.

### **Closing date for applications**

Applications must be submitted by **June 30, 2018** Applications received after this date will not be considered for funding.

Please note that the OeAD GmbH and the National Agency for Scientific Research and Innovation (NASRI) will not be held responsible for applications that were not received. Researchers are also advised to ensure that their research partners` applications are submitted and have also been received in the partner countries in time.

### **Further information**

<b>In Austria</b>	<b>In Albania</b>
OeAD GmbH (Austrian Agency for International Cooperation in Education and Research) ICM – Centre for International Cooperation & Mobility	National Agency for Scientific Research and Innovation
<b>Mrs. Monika Wiederseder-Staltner</b> Ebendorferstraße 7 A-1010 Vienna Tel. +43 (0)1/53408-445	<b>Mr. Geron KAMBERI</b> General Director Tel: +355 4 2222409 Mob: +355 69 82 13 143 Fax: +355 4 2222409
Email: <a href="mailto:wtz@oead.at">wtz@oead.at</a> Website: <a href="http://www.oead.at/wtz">www.oead.at/wtz</a>	Email: <a href="mailto:geron.kamberi@akti.gov.al">geron.kamberi@akti.gov.al</a> Website: <a href="http://www.nasri.gov.al">www.nasri.gov.al</a>